



KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE

**PROGRAMET PARTIAKE
PARAZGJEDHORE,
PROGRAMI I QEVERISË DHE
PRITJET E QYTETARËVE
(A TAKOHEN NË NDONJË PIKË?)**

**PRE-ELECTORAL PARTY
PROGRAM,
THE GOVERNMENT'S PROGRAM
AND CITIZEN'S EXPECTATIONS
(DO THEY MEET AT ANY POINT?)**



PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| LISTA E SHKURTESAVE | 2 |
| HYRJE | 3 |
| 1. PROGRAMET PARAZGJEDHORE | 4 |
| 1.1. Partia Demokratike e Kosovës - PDK | 4 |
| 1.2. Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK | 6 |
| 1.3. Aleanca Kosova e Re - AKR | 7 |
| 1.4. Lidhja Demokratike e Dardanisë - LDD | 8 |
| 1.5. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK | 9 |
| 2. PRITJET E QYTETARËVE | 11 |
| 2.1. Luftimi i krimit dhe korrupsionit | 12 |
| 2.2. Punësimi | 12 |
| 2.3. Zhvillimi i infrastrukturës | 13 |
| 2.4. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian | 14 |
| 2.5. Kujdesi shëndetësor | 15 |
| 2.6. Arsimi | 17 |
| 3. PROGRAMI QEVERTAR KUNDREJT PRITJEVE TË QYTETARËVE DHE PROGRAMEVE PARA-ZGJEDHORE | 19 |
| 3.1. Programi qeveritar kundrejt pritjeve të qytetarëve | 19 |
| 3.2. Programi qeveritar kundrejt programit parazgjedhor partiak | 20 |
| PËRFUNDIM | 22 |
| BIBLIOGRAFIA | 22 |

STAFI

Ismet KRYEZIU
Drejtor Ekzekutiv

Valmir ISMAILI
Menaxher Projekti

Bleranda ZOGAJ
Menaxhere Projekti

Fitore ZENELI
Koordinatorë

Ramadan KLISURICA
Koordinator

Vjollca VOGËL
Menaxhere e Financave

Konsultant Profesional
Yll BULESHKAJ
Violeta ZEKA
Edita MUSTAFA

Përgatitja për shtyp:
Arsim Gjinovci

LISTA E SHKURTESAVE

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR - Aleanca Kosova e Re
BE - Bashkimi Evropian
DP - Deputet i Parlamentit (Kuvendi i Republikës së Kosovës)
KDI - Instituti Demokratik i Kosovës
KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor
LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës
ORA - Partia Reformiste ORA
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK - Partia Demokratike e Kosovës
PSHDK - Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës
UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Adresa - Address

KDI - Kosova
Democratic Institute

email & web

office@kdi-kosova.org
www.kdi-kosova.org

Qershor
2008 - Prishtinë

Në një hulumtim të bërë disa muaj më parë nga KDI, të titulluar Komunikimi dhe Përfshirja e Qytetarëve në Politikat Programore, u nxorën brengat kryesore të qytetarëve që janë shprehur duke zgjedhur prioritetet në fushat ku institucionet qeveritare duhet të punojnë më intensivisht. Në mënyrë që të paraqitet një pasqyrë e plotë, ky hulumtim do të bëj një analizë krahasuese të interesave të qytetarëve, programeve zgjedhore të partive politike dhe programit të qeverisë së Kosovës. Më tepër, ky punim do të mundohet të gjej ndikimin e mundshëm të programeve parazgjedhore partiake në hartimin e programit qeverisës. Fillimisht u mendua që në këtë punim të përfshihen edhe iniciativat legjislative që janë bazuar në prioritetet e programit parazgjedhor, mirëpo duke pasur parasysht që Kuvendi i Kosovës në gjashtëmujorin e parë të punës së tij kryesisht u përqendrua në miratimin e 41 ligjeve që rrjedhin nga Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisarit, u vendos që ky krahasim të bëhet në një punim vijues. Pra, duke u bazuar në arsyet e mësipërme, ky punim është përqendruar kryesisht nga dega e ekzekutivit por duke krijuar një bazë e cila do shërbej për hulumtimin e mëvonshëm. Punimi vijues planifikohet të realizohet deri në fund të këtij viti, ku qëllim kryesor do jetë shqyrtimi i mënyrës të deputetëve nga parti të ndryshme për të realizuar programin e tyre parazgjedhor gjatë hartimit, miratimit dhe amandamentimit të ligjeve. Ky punim është vetëm një pjesë e mozaikut të projektit të monitorimit nga afër të punës së Kuvendit të Kosovës të cilin është duke e bërë Instituti Demokratik i Kosovës. Metodologjia e përdorur për të hartuar këtë punim është kryesisht analiza krahasuese e programeve parazgjedhore të partive politike duke përdorur burime primare si dhe burimeve sekondare, si prezantime të ndryshme në media të këtyre programeve, etj.. Programet parazgjedhore nuk ishin të krahasueshëm në të gjitha pikat si dhe një numër i madh i problemeve u hasën duke filluar që nga qasja në këto programe. Sidoqoftë, kjo iniciativë duhet konsideruar si një nismë modeste që të mbulohet ajo që deri më tani nuk është bërë nga analiza dhe hulumtime paraprake.

Ky punim përbëhet nga tri pjesë kryesore: a) një analizë e shkurtër e programeve partiake parazgjedhore, b) krahasim i programeve me prioritetet e qytetarëve dhe c) krahasim i prioritetëve të ekzekutivit dhe legjislativit kundrejt prioritetëve të qytetarëve. Për fund ky punim do të mundohet të nxjerr disa përfundime/rekomandime për palët e interesuara.

Shënim për terminologji: 'programe partiake' përdoret për të nënkuptuar programe të partive politike.

Kjo pjesë do të paraqet një përmbledhje të shkurtër dhe analizë të programeve partiake parazgjedhore të pesë partive kryesore parlamentare. Arsyeja pse janë zgjedhur vetëm pesë parti ka qenë për shkakë metodologjike si dhe është vlerësuar se këto parti kanë fuqi si dhe qasje direkt në miratimin e ligjeve si dhe të politikave qeveritare. Përveç specifikave secila parti ka edhe pika të përbashkëta që mund të nxirren si më poshtë.

1.1. Partia Demokratike e Kosovës - PDK

PDK-ja ka hartuar një program parazgjedhor të cilin nuk e publikuar asnjëherë si një të vetëm. Kjo e bën këtë parti të veçantë nga të tjerat ku programi i saj mund të gjendet vetëm pjesë-pjesë, e kjo vetëm në versionin elektronik. Kur u kontaktuan zyrtarët e PDK-

PDK-ja ka hartuar një program të cilin nuk e ka publikuar asnjëherë si një dokument të vetëm.

së në lidhje me programin, zyrtar të kësaj partie dhanë mundësinë e vetme duke rekomanduar që të hulumtohen dy faqet e internetit: ai zyrtar i partisë (www.pdk-ks.org) si dhe tjetri i përdorur gjatë zgjedhjeve (www.krenouhu.com). Kjo shkaktoj probleme në analizimin e këtij programi pasi që burimet ishin të kufizuara dhe vetëm të dorës së dytë. Sidoqoftë, substanca e programit parazgjedhor ishte ndarë në shtatë kapituj që mbulojnë bregat kryesore:

- 1) pavarësinë;
- 2) ekonominë dhe punësimin;
- 3) arsimin;
- 4) kujdesin shëndetësor;
- 5) pensionet;
- 6) qeverisjen dhe reformën dhe;
- 7) sigurinë.

Në lidhje me pikën e parë të programit parazgjedhor, PDK-ja premtoi të përshpejtoj procesin e pavarësimin të Kosovës sepse vlerësohej të jetë i rëndësishëm më të madhe. Megjithatë kjo parti pranon që

Ky program ka shumë detaje të mikro-menaxhimit por ka lënë pa përgjigje pyetje thelbësore siç është rruga që duhet ndjekur për të arritur në furnizimin 24 orë energji elektrike në ditë në një periudhë afatmesme.

pavarësia nuk është zgjidhje e të gjitha problemeve të Kosovës, mund të shërbej si lehtësim i zgjidhjes së tyre. Duke punuar më shumë për Kosovën e pavarur, PDK-ja premtonte se do të kontaktonte 'miqtë' nga Evropa për ti ndihmuar në këtë ndërmarrje. Si pikë e parë e radhitur nga PDK-ja mund të konsiderohet se kjo pikë me shpalljen e

pavarësisë tashmë është përmbushur.

Në pikën e dytë, të përqendruar në ekonomi dhe punësim, ku thuhej se përkundër problemeve ekonomike që po has Kosova është premtuar një periudhë e 'shpresës dhe mirëqenies'. Për të zvogëluar

PARAZGJEDHORE

1. PROGRAMET PARAZGJEDHORE

papunësinë, PDK-ja ka planifikuar të mundësoj kredi me kamata të ulëta për kompanitë që premtojnë rritje të numrit të punëtorëve, e në anën tjetër me ulje të taksave të tentohet të tërhiqen korporatat ndërkombëtare që të investojnë në Kosovë. Edhe pse programi premtonte intervenime radikale që të përmirësohet pozita e punëtorëve, duke theksuar rritjen e pagave, si dhe të rritjen e nivelit të punësimit, shumë pak detaje janë dhënë se si do të realizohet kjo.

Kapitulli i tretë, i kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me arsimimin që konsiderohet si një vegël drejt arritjes së një zhvillimi të përgjithshëm. Sipas programit parazgjedhor, planifikohet të ketë arsimim fillor dhe të mesëm të obligueshëm, të kompjuterizohen shkollat, si dhe me përmirësimin e tërësishëm të kualitetit të arsimimit të kthehet Kosova në një 'Luginë Silikoni'. Këto premtime vetëm sipërfaqësisht janë mbështetur me argumente dhe detaje se si do të funksionoj kjo në realitet.

Fusha e katërt është kujdesi shëndetësor. Këtu, PDK-ja ka planifikuar të dizajnoj një sistem shëndetësor që siguron kushte për kujdes më të mirë. Programi parazgjedhor planifikon që të zbatohet duke i furnizuar me materiale të nevojshme stafin mjekësor të spitaleve. Vëmendje e veçantë planifikohej t'i kushtohej personave në moshë të shtyer dhe pensionistëve duke ju ofruar shërbime të lira shëndetësore duke ju ndihmuar të ikin nga dilema 'ushqimin apo ilaçet'. Ky kapitull pasohet nga premtime për kujdes për pensionistët, duke ju premtuar dyfishim të pensioneve që të jetojnë me më shumë dinjitet.

Qeverisja nën udhëheqjen e PDK-së premtonte të jetë më e përgjegjshme, transparente, si dhe më pak e korruptuar duke synuar t'i shërbej qytetarit. Sipas programit parazgjedhor të PDK-së,

Kosova ka nevojë për siguri në mënyrë që të bëhet vend më i sigurt për të jetuar dhe punuar. Si shtesë të shtatë kapitujve të programit parazgjedhor, PDK-ja i ka shënuar edhe dy fusha specifike: infrastrukturën dhe energjinë. Përveç premtimeve për të përmirësuar infrastrukturën rrugore nuk janë prezantuar edhe burimet e financimit që do të përdoren për këto projekte gjigante. Në anën tjetër, programi për energji

është i zhvilluar në më shumë detaje por me pak substancë. Ky program ka shumë detaje të mikro-menaxhimit por ka lënë pa përgjigje pyetje thelbësore siç është rruga që duhet ndjekur për të arritur në furnizimin 24 orë energji elektrike në ditë në një periudhë afatmesme.



1.2. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

LDK-ja paraqiti para votuesve një program parazgjedhor 44 faqesh, i cili thuhet se bazohet në vizionin e presidentit historik, të ndierit dr. Ibrahim Rugova, për një Kosovë të pavarur, sovrane dhe demokratike. Ngjashëm me programin e PDK-së, edhe për LDK-në pika fillestare është pavarësia dhe shtet-formimi i Kosovës, duke premtuar zhvillim ekonomik dhe politik. Në pjesën fillestare, çuditërisht, thuhet se LDK nuk premtonte por puna e tyre flet më së miri. Kjo parti ka thënë se përkrah ruajtjen e traditave të mira por edhe kultivimin e vlerave moderne. Kjo është partia e vetme e cila në programin e vet zgjedhor thotë se është kundër çdo forme të dhunës dhe se lufton për kultivimin e lirisë individuale dhe tolerancën. Për më shumë, LDK-ja zhvillon një kapitull të veçantë për integrimet shqiptare dhe evropiane.

Për sa i përket qeverisjes, LDK-ja bën një listë të prioriteteve si më poshtë: Rendi publik dhe sundimi i ligjit, përmirësimi i funksionalitetit të policisë që ti mundësoj luftimin e krimit dhe pengimin e kalimit ilegal të kufijve, sistemi gjyqësor të jetë më funksional, zhvillimi i Forcës Mbrojtëse të Kosovës me tipare apolitike dhe profesionale, krijimi i kushteve atraktive për të tërhequr investitorët e huaj që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, ngritje e të hyrave buxhetore sipas planit, dialog dinamik me shtetet fqinje përmes mekanizmit të stabilizimit asociativ të BE-së, bashkëpunim rajonal, zhvillim të politikës së jashtme që mbrojnë interesat e kosovarëve, zvogëlim të administratës shtetërore për të ulur shpenzimet buxhetore, fillim të zbatimit të praktikave më të mira të qeverisjes elektronike, përmirësim të përfaqësimit të barabartë gjinor në qeverisje dhe të rregullimit të sistemit të sigurimit social dhe shëndetësor.

LDK-ja ka paraparë të hapë globalisht ekonominë e Kosovës, duke vlerësuar se në atë mënyrë rriten mundësitë për t'u zhvilluar më shumë ekonomikisht. Zhvillimi ekonomik sipas LDK-së mund të arrihet duke luftuar korrupsionin, rritur eksportet dhe integrimin në Bashkimin Evropian. Qëllimi i LDK-së është që ta kthejë Kosovën nga importues i të mirave materiale në eksportues të dijes. Dija që nevojitet do të sigurohet përmes përmirësimit dhe reformimit të sistemit të arsimit duke pasur arsimim më cilësor. Sipas LDK-së, bujqësia mund të jep një kontribut të veshëm duke u zhvilluar në 'fshatrat evropiane'. Shteti do duhej në rastin e bujqësisë t'i përkrah fermerët me kredi me kamata të përballeshme, por në program mungojnë burimet e mundshme financiare. Për më tepër, sa i përket energjisë elektrike përveç premtimit për përmirësim, nuk është dhënë ndonjë rrugëdalje. Në fund mund të thuhet se programi parazgjedhor i LDK-së mund të vlerësohet si një konglomerat i prioriteteve dhe ku dyfishime të shumta mund të vërehen.

Programi parazgjedhor i LDK-së mund të vlerësohet si një konglomerat i prioriteteve dhe ku ka dyfishime të shumta.

1.3. Aleanca Kosova e Re - AKR

AKR-ja si një parti e themeluar rishtazi, konkurroi për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2007. Kjo parti i kushtoi rëndësi të madhe shpërndarjes së materialeve propagandistike e në rastin tonë edhe programit parazgjedhor. Programi rreth 33 faqesh i kësaj partie që nga paragrafi i parë mund të dallohet që i ka kushtuar rëndësi të veçantë dimensionit ekonomik dhe që e kishte edhe si prioritet kryesor. Për dallim nga subjektet tjera politike, AKR-ja kishte ndarë programin e saj parazgjedhor në katër departamente të cilat do të ishin përgjegjëse për të implementuar të njëjtin, ato departamente ishin: Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Arsimit, Departament i Punëve të Jashtme dhe Departamenti i Punës dhe Shërbimeve Publike. Secili nga këto departamente përbante edhe nënndarje për tu marr me zgjidhjen e problemeve specifike.

Në pjesën e parë, varfëria dhe prapambeturia ekonomike ishin vlerësuar të ishin problemet kryesore që bllokojnë Kosovën. AKR-ja ka parë jo-sinqeritetin, paditurinë, jo-profesionalizmin, jo-transparencën, keqpërdorimin e burimeve, korrupsionin dhe papërgjegjshmërinë si caqe për trajtim të menjëhershëm. Duke pasur për qëllim luftimin e prapambeturisë ekonomike, ishte planifikuar të zbatohet programi me punë të sinqertë dhe politika të kujdesshme fiskale. Në kapitullin e parë, AKR ka shpjeguar deri në detaje se çka mendonin ata me politika të kujdesshme fiskale duke përfshirë: zvogëlimin e pragut të TVSH-së nga 50.000 në 30.000 euro, pezullimin e taksave për makineritë prodhuese, themelimin e një policie financiare për të disiplinuar bizneset si dhe masa tjera të ngjashme. E gjitha kjo do të bëhej me qëllim të reduktimit të shkallës së papunësisë dhe të stimulimit të prodhimit. Infrastruktura dukej të ishte një cak tjetër i AKR-së e cila përveç riparimit të infrastrukturës ekzistuese parashihte edhe autostrada të reja si ajo që do lidhte Gjakovën me Shkodrën, e cila vlerësohej që do të ishte tepër e rëndësishme për ekonomin dhe tregtinë në pjesën perëndimore të Kosovës dhe më gjerë. AKR ka vlerësuar se infrastruktura energjetike ka nevojë për intervenim të menjëhershëm si dhe decentralizim të detyrave.

Ngjashëm me partitë tjera, AKR ka parë potencial për zhvillim nëse investohet në arsimim kualitativ duke hartuar plan-program modern arsimor, pajisur me laboratorë, dhe duke u dhënë autonomi më të madhe institucioneve shkollore. Duke pasur parasysh se institucionet arsimore kosovar janë në proces të reformimit, një reformë tjetër rrënjësore

Përkundër shpjegimeve të mira duket se propozimi i AKR-së do të ishte vështirë i zbatueshëm në periudhë afat-shkurtër.



(siç është implementimi i sistemit 6+4+2+1) do të mund të kishte kundër-efekte që do mund ta ngulfasin plotësisht këtë sistem.

Për sa i përket politikës së jashtme, AKR ka planifikuar të përqendrohet në krijimin e imazhit të Kosovës si një vend që promovon paqe, siguri, demokraci të qëndrueshme dhe zhvillim rajonal. Një detaj interesant është që AKR-ja ka konsideruar që me atë parti në qeveri Kosova do te integrohej në BE si partner e jo si lypës. Një nënkaptull ka qenë i hartuar për integrimin e Kosovës në BU përmes Marrëveshjes për Stabilizim Asocim.

Departamenti i Punës dhe Shërbimeve Publike do duhej të merrej me punësimin dhe krijimin e infrastrukturës ligjore të nevojshme. Në kapitullin e fundit është përfshirë edhe kujdesi për pensionistët si dhe nevoja për ri-dizajnimin e sistemin pensional dhe bërjen më të fortë të sistemit shëndetësor. Përkundër shpjegimeve të mira duket se propozimi i AKR-së do të ishte vështirë i zbatueshëm në periudhë afatshkurtër.

1.4. Lidhja Demokratike e Dardanisë – LDD

LDD-ja ngjashëm me LDK-në, nis programin parazgjedhor me paragrafin që shpreh lojalitet në idetë e farkuara nga presidenti Rugova. Në të vërtetë, ky program është program i përbashkët i LDD-së me Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës (PSHDK) si partner në koalicionin parazgjedhor. Programi i kësaj partie përmban pika të caktuara të programit të tyre që shumë lehtë mund të

Përmbajtje e programit të LDD-së mund të thuhet se arriti të përmend shumicën e brengave të kosovarëve por ka dështuar në dhënien e zgjidhjeve të tyre.

përcillen por që janë shumë sipërfaqësore. Programi parazgjedhor i koalicionit parazgjedhorë është i ndarë në nëntë kapituj: Qeverisja Qendrore dhe Lokale, Ndarja e Pushteteve, Zhvillimi Ekonomik, Tregtia, Turizmi dhe Infrastruktura, Arsimi dhe Shkenca, Shëndeti, Integrimet Euro-Atlantike, Siguria, Ambienti dhe Planifikimi, Kultura Rinia dhe Sportet. Kjo listë e gjatë

e çështjeve dhe vetëm dhjetë faqe program parazgjedhor tregon me së miri se sa thellë janë prekur çështjet.

Për sa i përket kapitullit të parë dhe të dytë, pushteteve dhe ndarjes së tyre, programi parazgjedhor i LDD-së përkrah idenë e zhvillimit të njëjtë për të gjitha komunat dhe për një lloj ndarje/delegimi të pushteteve për në nivele lokale. Ndërsa, niveli qendror i qeverisjes duhet të mbetet i ndarë në mënyrë të qartë në tri degët e tij: legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv.

Sa i përket sundimit të ligjit, LDD-ja ka premtuar marrje masash në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët pa ndonjë dallim si dhe do të merrej parasysh se të gjithë qytetarët do të ishin të barabartë para ligjit, duke i bërë institucionet shtetërore më të fuqishme dhe më të besueshme në sytë e qyte-

PARAZGJEDHORE

1. PROGRAMET PARAZGJEDHORE

tarëve.

Kapitulli për ekonominë është më i gjati si dhe jep më së shumti detaje në lidhje me atë se si e sheh kjo parti zhvillimin dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të Kosovës. Duke krijuar kornizën ligjore të nevojshme dhe që i favorizon bizneset, kjo parti tenton të tërheq investime dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë papunësinë. Në procesin e punësimit mendohej të kihet parasysh balancimi gjinor, e në disa raste ndoshta do të ishte e nevojshme të fuqizoheshin gratë. Ekonomia në rrafshim lokal ishte planifikohet të zhvillohet bazuar në Kartën Evropiane për Qeverisje, e për këtë parashihej që një pjesë e punës t'i lihej edhe institucioneve lokale. Përveç bërjes së listës së çështjeve që përkrahen nga partia politike, e sidomos pjesa për ekonominë, programi i LDD-së më tepër i ngjan një liste dëshirash sesa çfarëdo programi që do t'u gjente përgjigje çështjeve të ndryshme.

Zhvillimin e arsimit, LDD-ja e ka planifikuar me hartimin e një kornize ligjore moderne, pastaj me themelimin e fondacioneve të ndryshme që do të përkrahnin studentët dhe hulumtuesit në studime post-diplomike. Gjendja e tanishme e kujdesit shëndetësorë duket ta ketë brengosur LDD-në, kjo ka rezultuar me zhvillimin e një strategjie për zhvillim të institucioneve që merren me këtë çështje, duke përfshirë përmirësimin e kushteve të punës si dhe ndërtimin e hapësirave të reja spitalore.

Për ta përmbledhur, përmbajtje e programit të LDD-së mund të thuhet se arriti të përmend shumicën e brengave të kosovarëve por ka dështuar në dhënien e zgjidhjeve të tyre.

1.5. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK

AAK-ja është partia që ka drejtuar qeverinë në legjislaturën e kaluar. AAK-ja, për dallim nga LDD-ja, ka pasur një program parazgjedhor kuantitativ, më tepër se 60 faqe. AAK-ja në detaje ka shpjeguar planet e saj për Kosovën dhe programi i saj ka qenë i ndarë në katër pjesë: a) shtet ndërtimin, rendin dhe ligjin; b) zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë; c) shoqërinë e arsimuar, të shëndoshë dhe konkurrense; dhe d) infrastrukturën, bujqësinë dhe mbrojtjen e ambientit. Secila nga fushat e lartpërmendura kanë qenë të ndara në aktivitete dhe brenga të detaizuara.

Njëjtë sikurse edhe programet parazgjedhore të partive tjera politike, përveç AKR-së, prioriteti i parë i është dhënë shtet-ndërtimit. Në grupin e njëjtë janë përfshirë: drejtësia, sistemi i



sigurisë, integrimet euroatlantike dhe politika e jashtme. AAK-ja ka pasur një listë të detaizuar të institucioneve që duhet të merren dhe çka saktësisht duhet të bëhet me: reformimin e sistemit të drejtësisë, rrjetëzimin e gjykatave, infrastrukturë ligjore më të mirë, sigurimin e bursave për studentë që janë të interesuar për tu studiuar në fushat ku institucionet kosovare kanë mungesë të ekspertizës (toksikologji,

AAK-ja ka pasur një nga programet parazgjedhore më të detaizuara, që në të njëjtën kohë ka qenë lehtë për t'ju qasur dhe ka qenë një ndër më gjithëpërfshirësit, duke përfshirë projektet e implementuara sikurse edhe ato që do të implementohen.

forensikë, etj.) dhe të ngjashme. Sa i përket integriteteve evropiane është hartuar një udhërrëfyes që duket si një vazhdimësi e asaj se çfarë ishte bërë deri në atë kohë, veçanërisht e Planit të Partneritetit për Paqe, dhe Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim.

Në pjesën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, AAK-ja ka paraparë mundësinë që zhvillimi ekonomik mund të arrihet vetëm në

ekonomi të bazuar në sektor privat. AAK-ja ka përkrahur në masë të madhe privatizimin e kompanive publike dhe zvogëlimin e taksave për të stimuluar ringjalljen ekonomike të Kosovës. Në planin e saj për një shoqëri të arsimuar ka një program që do të merret drejtpërsëdrejti me arsim, kujdesin shëndetësor, rininë, pozitën e gruas në shoqëri por duke përkrahur kategoritë e qytetarëve që kanë dalë nga lufta e UÇK-së. AAK-ja është njëra nga partitë e pakta që ka hartuar një nënkapitull për diasporën shqiptare duke premtuar që t'i mbaj ata të organizuar në lobe të forta në Amerikë dhe Evropë, si dhe duke hapur kurse shtesë në gjuhën angleze në mënyrë të t'i mbaj ata të lidhur me atdheun e tyre.

AAK ka pasur një listë të premtimeve të realizuara nga fushata parazgjedhore paraprake për të përkrahur programin e saj aktual si real dhe i zbatueshëm. Njëjtë sikurse LDK-ja dhe LDD-ja, edhe AAK-ja e lidh suksesin e vetë me liderin e saj i cili në atë kohë ka qenë në Tribunalin e Hagës. Edhe pse një numër raportesh tregojnë që Kosova ka papunësinë më të madhe në Evropë, AAK-ja e radhit si sukses zvogëlimin e papunësisë për 8%, njëjtë sikurse edhe ndihëm sociale për 40 mijë familje kosovare.

Programi parazgjedhor i AAK-së nuk e përmend askund dështimin e qeverisë për të luftuar krimin, veçanërisht çështjen e korrupsionit ku Kosova është e radhitur njëra nga më të korrumpuarat në rajon, pastaj problemet me energji (prapë në mënyrë të palogjikshme politikat e energjisë dhe kornizat ligjore të energjisë janë radhitur si suksese). Për ta përfunduar, AAK-ja ka pasur një nga programet parazgjedhore më të detaizuara, që në të njëjtën kohë ka qenë lehtë për t'ju qasur dhe ka qenë një ndër më gjithëpërfshirësit, duke përfshirë projektet e implementuara sikurse edhe ato që do të implementohen.

Në një hulumtim të bërë nga KDI, në dhjetor të vitit 2007 dhe janar të vitit 2008, të anketuarit kanë radhitur gjashtë fusha si më të rëndësishme, nga 12 gjithsej. 54% e të anketuarve zgjedhën fushën e luftimit të krimit dhe korrupsionit si brengën e tyre më të madhe, duke u pasuar nga papunësia 42%, zhvillimi i infrastrukturës 32.5%, anëtarësimi në BE ishte zgjedhur nga 24.4% e të anketuarve, pastaj kujdesi shëndetësor nga 22% dhe arsimi nga 18.6% e tyre. Duke u bazuar në pritjet e qytetarëve, programet parazgjedhore të partive politike do të krahasohen/analizohen.

2.1. Luftimi i krimit dhe korrupsionit

Nga shumë organizata joqeveritare dhe institucione tjera kërkimore Kosova është radhitur në pozita të larta si një nga vendet më të korruptuara në rajon dhe me një nivel të lartë të krimit ordiner dhe të organizuar. Edhe në hulumtimin tonë të anketuarit kanë radhitur krimin dhe korrupsionin si një nga fushat më të rëndësishme me të cilat duhet të merret qeveria. Paralelisht me këtë, programet parazgjedhore të partive politike do të shqyrtohen nëse e kanë mbuluar këtë temë.

PDK-ja e përfshin luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në kapitullin dedikuar qeverisjes. Është e fundit në listë, por rëndësia e kësaj problematike vërehet. Për shkak të materialit të pakët të bërë publik nga PDK, edhe vendosmëria për

Për shkak të materialit të pakët të bërë publik nga PDK, edhe vendosmëria për të luftuar korrupsionin dhe praktikën e keqpërdorimeve duket të ketë mbetur pa ndonjë strategji të qartë.

të luftuar korrupsionin dhe praktikën e keqpërdorimeve duket të ketë mbetur pa ndonjë strategji të qartë.

LDK-ja në programin e saj parazgjedhor e konsideron krimin e organizuar si një pengesë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e Kosovës. Luftimi i krimit do të jetë një nga detyrat kryesore të të gjitha institucioneve shtetërore duke filluar nga policia, shërbimet inteligjente të Kosovës dhe nga bashkëpunimi me agjencitë ndërkombëtare që luftojnë krimin e organizuar. LDK-ja duket të jetë e vetëdijshme për problemin dhe e përmend përgjatë tërë programit rëndësinë e luftimit të krimit dhe zvogëlimin e korrupsionit. Korrupsioni dhe krimi do të zvogëlohen me rritjen e dënimeve dhe me bashkëpunim më të mirë të institucioneve të policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve. AKR-ja në programin e vetë parazgjedhor që kryesisht ka qenë i përqendruar në ekonomi, përmend rëndësinë e luftës kundër krimit dhe korrupsionit si pengesa për zhvillimin ekonomik.

Sidoqoftë, masa e vetme e përmendur për të luftuar këtë fenomen ka qenë rritja e funksionimit të shtetit dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve.

LDD-ja, në programin e vetë parazgjedhor vetëm dy herë e përmend korrupsionin, ndërsa krimin vetëm një herë, duke zënë vetëm 5% të programit në përgjithësi. LDD-ja e sheh fuqizimin e aparatit të shtetit si mënyrën e vetme për të pasur luftë të suksesshme kundër krimit dhe korrupsionit.

AAK-ja po ashtu nuk ka ndonjë kapitull apo nënkaptull që do të merrej me luftën kundër krimit dhe korrupsionit por ajo thekson problemet që i shkakton ky fenomen dhe e vetmja mënyrë për të ecur përpara konsiderohet bashkëpunimi më i mirë brenda institucioneve shtetërore. Përfundimisht, AAK-ja e konsideron si sukses themelimin e një zyre të veçantë për ndjekje penale për tu marrë me çështje që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore si dhe çështje tjera të ngjashme.

2.2. Punësimi

Pas krimit dhe korrupsionit, punësimi duket të brengos më së shumti qytetarët e Kosovës. Përgjithësisht të gjitha partitë politike kanë pasur një kapitull të veçantë në lidhje me atë se si të rritet punësimi. Disa nga partitë në tërësi e kanë zhvilluar programin e tyre në përmirësimin e ekonomisë së Kosovës dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Vetëm një përqindje e vogël e hapësirës në program i është kushtuar kësaj çështje nga partitë politike. Pothuajse gjysma e qytetarëve e shohin punësimin si një nga fushat ku partitë duhet të përqendrohen fuqimisht.

Punësimi merr rreth 7.14% të programit parazgjedhor të PDK-së. Kjo parti ka planifikuar të bëjë “luginën e silikonit” duke arsimuar rininë dhe për t’i bërë ata të aftë për tregun e punës. Për shkak të llojit kuantitativ të programit, ai është shumë sipërfaqësor dhe pa ndonjë argument se si mund të zvogëlohet papunësia.

LDK-ja në anën tjetër mbulon më mirë çështjen e papunësisë por si pjesë e programit të përgjithshëm parazgjedhor është vetëm rreth 4.55%. Punësimi do të ishte më i lartë nëse LDK do të implementonte këtë program që ka për qëllim zvogëlimin e papunësisë në terma afatgjatë. LDK-ja është e gatshme të negociojë me vendet perëndimore për të siguruar punësim sezonal dhe për të përkrahur bizneset që dëshirojnë të hapin vende të reja të punës. LDK-ja kushton vëmendje të madhe në të drejtat e barabarta për të qenë i punësuar në institucionet qeveritare pa marrë parasysh gjininë dhe kombësinë.

Rreth 37% e planit parazgjedhor të AKR-së merret me zhvillimin ekonomik dhe punësimin, por vetëm 5% është e lidhur drejtpërdrejt me punësimin. Kjo parti ka planifikuar të krijojë një numër të madh të vendeve të punës por kjo nuk përkrahet me shpjegime të mjaftueshme se si kjo do të mund të funksiononte në realitet. Sipas këtij programi parazgjedhor sistemi i arsimit duhet të përqendrohet në arsimimin dhe përgatitjen e të rinjve për tregun e punës.

LDD-ja daljen nga varfëria e sheh duke e rritur punësimin. Bazuar në programin e LDD-së, kjo do të mund të realizohet me integrimin e njerëzve në zhvillim dhe me dhënien e mundësive të barabarta për meshkuj dhe femra. Punësimi përbën vetëm 5.5% të programit të LDD-së që e ka paraqitur para votuesve të vetë.

AAK-ja diskuton punësimin në shumicën e programit të saj parazgjedhor, por në mënyrë të veçantë vetëm në 4% të tij. AAK-ja ka premtuar që të rrisë punësimin me anë të politikave pro-punësimi që do t'a mbanin fleksibilitetin e tregut të punës. Papunësia, sipas AAK-së, mund të zvogëlohet vetëm me krijimin e bazës ligjore për stimulim të punësimi, kualifikimin profesional të njerëzve të interesuar, si dhe me krijimin e kushteve për bizneset familjare (kryesisht në fushat e bujqësisë).

2.3. Zhvillimi i infrastrukturës

Kosova, nëntë vite nga mbarimi i luftës, akoma përballet me probleme të infrastrukturës. Pengesat që qytetarët e Kosovës duhet t'i kalojnë çdo ditë dolën edhe nga hulumtimi jonë, ku rreth 32.5% e të anketuarve zgjedhën infrastrukturën si një nga fushat ku institucionet qeveritare duhet të fokusohen. Duke mbajtur në mend këto probleme dhe duke menduar rreth pritjeve të qytetarëve, shumë nga partitë politike kanë paraqitur projekte ambicioze për të ndërtuar infrastrukturën e rrugëve dhe elemente tjera të saj.

PDK-ja ka bërë një projekt të ndarë i cili ka shprehur përcaktimin e saj për të përmirësuar gjendjen e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë po ashtu infrastrukturën e nevojshme për përcimin e energjisë elektrike dhe gjëra tjera të ngjashme. Së paku tri projekte të infrastrukturës rrugore me interes kombëtar me rreth 300 km autostradë janë planifikuar . Përveç infrastrukturës rrugore, PDK-ja ka planifikuar të zhvillojë infrastrukturë energjetike me anë të një plani për të bërë situatën energjetike më të qëndrueshme.

LDK-ja ka pasur si prioritet përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht infrastrukturën rrugore dhe paraprakisht ka përgatitur një

listë të rrugëve me prioritet. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore, energjisë dhe ujit në zonat rurale dhe urbane janë të renditura si brengat kryesore. LDK-ja ka premtuar përmirësimin e infrastrukturës së telekomunikacionit, teknologjisë informative dhe liberalizimin e tregut për këto shërbime, duke mbuluar kështu çështjet kryesore të kësaj fushe.

AKR-ja në programin e saj parazgjedhor e ka paraqitur infrastrukturën si një brengë të partisë dhe ka planifikuar që të përmirësoj infrastrukturën e rrugore që lidh zonat rurale dhe urbane, sikurse edhe konstruktimi i rrugëve për rëndësi kombëtare si autostrada Gjakovë-Shkodër, që përmirëson bashkëpunimin ndërkuftar si dhe autostrada tjera të brendshme. Përveç infrastrukturës rrugore, AKR-ja ka pasur plan për të konstruktuar dhe zhvilluar sistem të hekurudhës (po ashtu duke elektrifikuar atë) dhe transport ajror. Kjo do të mund të rregullohej me themelimin e një agjencie për siguri në komunikacion. LDD-ja përfshin problemin e infrastrukturës si një komponent të programit të saj. Kjo parti ka radhitur zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës: rrugëve dhe hekurudhave. Kjo ishte konsideruar si një investim në zhvillimin ekonomik që do të pasonte me infrastrukturë më të mirë. Është e çuditshme se në programin parazgjedhor të LDD-së ekziston vetëm një paragraf mbi infrastrukturën. Në anën tjetër AAK-ja ka një kapitull të tërë mbi infrastrukturën. AAK-ja ka listën më përfshirëse dhe i përgjigjet problemeve infrastrukturore që nuk janë të kufizuara vetëm në transport por tek energjia, minierat, mjedisi, ngrohja qendrore, telekomunikacioni, etj. Në këtë mënyrë AAK-ja duket të ketë fituar informata të detaizuara rreth nevojave për përmirësim pasi që ka qenë udhëheqëse e koalicionit qeverisës për tri vite.

2.4. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Shoqëria kosovare ka vlerësuar anëtarësimin në BE si një prioritet të lartë. Çdo parti ka pasur një pjesë të programit të saj që i është dedikuar integritimeve në BE. Mjaft e çuditshme por partia kryesore që është në koalicionin qeverisës ka vetëm një rresht në lidhje me integritimet në BE, përderisa partitë tjera kanë kapituj në vete për këtë çështje.

Përderisa PDK-ja është e paracaktuar për të krijuar një ekono-

Të gjitha partitë e shohin Kosovën në Evropë por programet e tyre parazgjedhore jo gjithnjë kanë rrugë të qartë që Kosova duhet ta ndjekë për të shkuar atje. (me përjashtim të AAK-së që i ka disa objektiva të qarta).

2. PRITJET E QYTETARËVE

mi të shëndetshme dhe punësim në mënyrë që të meritoj integrimin në BE, LDK-ja si qëllim kryesor të politikave të jashtme ka sigurimin e anëtarësimit në BE. Kjo parti ka planifikuar të përparoj nga Mekanizimi i Stabilizim Asocimit për të filluar nënshkrimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit. LDK-ja është gati të punoj në adaptimin e ligjeve duke i vetëdijësuar ministrinë që të përfaqëzojnë kornizën ligjore me standardet e BE-së të Acquis Communautaire në mënyrë që të lehtësojë anëtarësimin e mundshëm.

AKR-ja në anën tjetër ka deklaruar se do të hartojnë politikë të jashtme për t'i përmbushur objektivat e përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë evropiane për paqe dhe stabilitet në rajon. Në rrugën e integritimit AKR-ja ka premtuar që të përmbushë kriteret e Kopenhagës. Kjo parti ka përkrahur idenë e bashkëpunimit rajonal me vendet fqinje për të hapur rrugën drejt integritimeve evropiane dhe të fitoj të drejtën për të marrë statusin e anëtarit në BE.

LDD-ja ka pasur qëllim kompletimin e negociatave për të kompletuar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe në aspekt afatmesëm të fitoj statusin e vendit kandidat për anëtarësim. Në anën tjetër, AAK-ja ka konsideruar që Kosova vetëm e ka një start dinamik drejt integritimeve në BE nën udhëheqjen e kësaj partie. Deri në vitin 2009, AAK-ja ka planifikuar të nënshkruaj Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE-në. AAK-ja ka bërë listë shtatë-pikëshe të gjërave që duhen bërë për integrim dhe anëtarësim në BE, që përfshijnë hapat drejt anëtarësimit.

Për të përfunduar, të gjitha partitë e shohin Kosovën në Evropë por programet e tyre parazgjedhore jo gjithnjë kanë rrugë të qartë që Kosova duhet ta ndjekë për të shkuar atje. (me përjashtim të AAK-së që i ka disa objektiva të qarta). Kosova është duke u qeverisur nga PDK-ja ndërsa kjo parti politike gjatë fushatës parazgjedhore nuk i ka paraqitur elektoratit ndonjë plan se si kjo parti planifikon të integrojë vendin në BE.

2.5. Kujdesi shëndetësor

